



19/7 KBL
12.01.26

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASENIT LUMOR ERZEN

VENDIM

Nr.9, datë 23/12/2025

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR RINOVIM TË LEJES/AUTORIZIMIT, LIDHUR ME RINOVIMIN E LEJES NR. SERIE 00001, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.1, DATË 16.09.2020, "LEJE PËR PËRDORIM BURIMI UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME TEKNOLOGJIKE", TË SUBJEKTIT "NEKI ELEZI"

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, "Për Burimet Ujore" i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.319, datë 11.06.2025, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Erzen,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për rinovim të lejes/autorizimit, lidhur me rinovimin e lejes Nr.00001 serial "Leje për përdorim burimi ujor nëntokësor", miratuar me Vendim Nr.1 datë 16.09.2020, të subjektit "Neki Elezi", me vendndodhje: Njësia Administrative Sauk, Bashkia Tiranë.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Koordinatat e vendndodhjes së pus-shpimit:

X= 486188.3; Y= 4574287.2; Z= 160 m; (KRGJSH)

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi për të cilin do të përdoret uji: Për qëllime teknologjike.

Sasia e ujit që jepet në përdorim: $Q = 0.03$ l/sek

Volumi i shkarkimit të ujrave të përdorura: $Q = 1.4$ m³/ditë

Vendi i shkarkimit të ujrave të përdorura: Gropë septike

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ERZEN

AFRIM QENDRO

